



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:264261  
Datë: 24.01.2024  
Numri i dokumentit: 05232014

AA.nr.189/2023

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS -Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A... B..., përfaqësuar nga avokat A... S...-Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me bazë juridike kundërvajtje doganore, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të paditësit avokat A... S... nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.808/2016, të datës 01.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit A... B..., përfaqësuar nga avokat A... S... nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.808/2016, i datës 01.02.2023, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A... B..., kundër të paditurës Dogana e Kosovës me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi i datës 03.05.2016, dhe të detyrohet e paditura ti kthej mjetet monetare në vlerë 5,000 (pesëmijë ) SFR, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit dhe kamatën ligjore prej 3.5 %. Ndërsa në pikën II. të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokat A... S... nga Prishtina, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të vendos direkt lidhur me aprovimin e padisë dhe kërkesëpadinë pa e kthyer në rigjykim këtë lëndë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ( LKA ), gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar, të Doganës së Kosovës në Prishtinë 05.2.1/759/2013, të dt. 03.05.2016, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë A... B...-P./Gjilan, për rishqyrtimin e procesit mbi vërtetimin e gjobës dhe konfiskimin e mjeteve monetare me nr.08.7.1/52 të datës 14.03.2014, të lëshuar nga PKK Aeroport, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit 05.2.1/759/2013, të dt. 03.05.2016 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsytim se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor si: ankesa në Doganën e Kosovës, e dt.23.09.2013, ankesa e dt.30.10.2013, aktvendimi i Doganës së Kosovës 05.2.1/759, i dt.11.10.2013, aktvendimi i Doganës së Kosovës 05.2.1/759/2013, i dt.03.05.2016, deklarata e A... B..., (nuk identifikohet datë), vërtetimi për gjërat të cilat i konfiskohen palës i Doganës së Kosovës, i dt.30.08.2013, procesverbali mbi kundërvajtjen doganore i Doganës së Kosovës i dt.30.08.2013, fletë deponim i dt.31.10.2013, konkluzioni i Doganës së Kosovës 05.2.1/759, i dt.04.12.2013, 6 fotografi të hapësirës së brendshme të Aeroportit, konstatohet se paditësi duke vepruar në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit 03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit ka bartur mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë, në dalje-nisje duke mos e deklaruar me *shkrim* shumë e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në formë e përcaktuar nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar të doganës, me faktin se i njëjti është dashur ti paraqesë këto mjete monetare në fazën e duhur dhe në formën me shkrim, në këtë mënyrë duke mos respektuar dispozitat e lartcekura nuk përmbushë *detyrimin për të deklaruar*, andaj edhe pason gjoba prej 25 % të shumës së mjeteve monetare të padeklaruar në posedim të tij/saj. Deri te ky konstatim Gjykata e shkallës së parë kishte për bazë fillimisht faktin se bazuar në shenjzimin në Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”, në kuptim dhe të nenit 29 të Ligjit të sipërcituar duke pasur në vëmendje dhe dispozitat e referuara nga e paditura të UA 11/2009 në rastin e posedimit të mjeteve monetare të cilat kalojnë 10.000 euro, Gjykata konstaton se paditësi është dashur ti përmbahet shenjzimeve, të plotësoj formularin lidhur me posedimin e mjeteve mbi 10.000 euro (*të paraqesë me shkrim shumë e mjeteve monetare dhe burimin e tyre*) dhe të kaloj në korsin e kuqe, paditësi ka pasur detyrë që të deklaroj mjetet financiare para se të kaloj kontrollin e sigurisë dhe dokumenteve nga policia kufitare, duke plotësuar fillimisht formularin me shkrim për deklarimin e mjeteve monetare, si formë e përcaktuar nga dogana, në kuptim të nenit 29 të Ligjit të sipërcituar, e ku këtu rëndësi kishte procesverbali i datës 30.08.2013 nga zyrtari kompetent ku përcaktohet mes tjerash *se në dalje pas kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kontrollës përmes X-ray në ANP Adem Jashari është selektuar për kontrollë pasagjeri i lartshënuar. Pasi që është pyetur se sa ka mjete monetare të gatshme me vete ai është deklaruar se me vete ka 20 000 franka për blerje të patundshmërisë në Kosovë dhe pasi që blerja nuk është realizuar parat e njëjta i ka bartur me vete për ti kthyer mbrapa në Zvicër prej nga edhe deklaroi*

*se i ka bartur me vete.* Në këtë kuptim paditësi nuk i është përmbajtur detyrimit të tij që të plotësoj formularin për deklarimin e shumës që posedon me vete sepse sipas procesverbalit të datës 30.08.2013 konstatohet se këtu paditësi është selektuar për kontrollë në dalje pas kontrollit të pasaportave. Gjykata për të ardhur deri te ky konstatim kishte parasysh se paditësi mjaftueshëm ka qenë i informuar nga shenjëzimi brenda hapësirave të aeroportit lidhur me zonën e deklarimit monetar, shenjëzim ky i dëshmuar edhe përmes fotografive nga shenjëzimi në hapësirën e aeroportit të administruara si provë në shqyrtim gjyqësor, e të cilin deklarim të mjeteve monetare që posedon me vete paditësi e ka bërë *pas kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kontrollës përmes X-ray në ANP Adem Jashari dhe atë vetëm pasi është selektuar për kontrollë*, në këtë kuptim paditësi ka shmangur deklarimin monetar, duke shtuar këtu faktin se paditësi në padi ka deklaruar se qysh nga viti 1982 ka jetuar në Zvicër në këtë kuptim edhe frekuentimi i aeroportit do të ishte i pashmangshëm dhe në këtë rast kjo rrethanë e bën të paqëndrueshëm pretendimin se paditësi se nuk i ka vërejtur-nuk i ka kuptuar mbishkrimet lidhur me deklarimin e mjeteve të cilat posedon. Po ashtu për Gjykatën ishte i papranueshëm pretendimi se paditësi nuk është njohës i gjuhës shqipe dhe asaj angleze dhe se nuk i ka kuptuar mbishkrime, pretendime këto të pabazuar dhe në kundërshtim me provën në shkresa të lëndës e referuar si deklaratë e këtu paditësit e cila është e shkruar me shkrim dore me emër dhe mbiemër të këtu paditësit dhe po ashtu e firmosur nga i njëjti andaj në këtë mënyrë edhe pretendimi mbi mos kuptimin e shenjëzimit si pasoj e gjuhës është i pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara. Bazuar në të lartcekurat këtu paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmoi se i njëjti ka respektuar dispozitat ligjore të sipër cituara për faktin se i njëjti përkundë posedimit me vete të shumës monetare mbi 10 000 euro, nuk dëshmon plotësimin e formularin për deklarim (deklarimi në formën e shkruar), si formë kjo e përcaktuar nga Dogana për deklarimin e mjeteve monetare, i njëjti injoron korsin e kuqe dhe vetëm pas selektimit të të njëjti për kontroll (pas kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kontrollës X-ray) dhe parashtrimit të pyetjes deklaroi se ka mjete monetare me vet, duke vepruar kështu në kundërshtim me neni 29 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit e Terrorizimit. Kurse sa i përket pretendimit të paditësit se posa ishte pyetur i njëjti ka nxjerrë portofolin e tij dhe kishte nxjerrë 20 000 SFR, padyshim që një veprimi të tillë paditësi nuk kishte se si ti shmangej për faktin se veç ishte selektuar për kontrollë nga zyrtarët përkatës dhe me përfundimin e procedurës së kontrollit do të konstatohet gjendja përkatëse. Lidhur me periudhën e deklarimit të posedimit të mjeteve monetare nga paditësi dhe fazën në të cilën janë deklaruar mjetet monetare (pas kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kontrollës X-ray) që kishte me vete paditësi, Gjykata ja fali besimin mes provave tjera të administruara dhe procesverbalit të datës 30.08.2013, i dhënë nga organet përkatëse dhe kompetente, përderisa paditësi lidhur me deklarimin dhe pretendimin e tij nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Në këtë kuptim duke pasur parasysh provat e sipër cituar dhe duke mos bashkangjitur nga ana e paditësit asnjë provë të vetme lidhur me pretendimet e tij, gjykata e shkallës së parë konstaton se pretendimet e paditësit janë të pa mbështetura në prova dhe si të tilla të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe përmbajtjen dhe formën e aktit administrative të atakuar me padi por se gjykata u lëshua në merita të shqyrtimit të kësaj çështjeje andaj paditësi nuk ka arritur të dëshmoj një gjendje faktike tjetër nga kjo e vërtetuar në shqyrtim gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe pretendimet si në padi por nuk i aprovoi sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar dhe nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme.

Gjykata e shkallës së parë mori për bazë konstatimet si në Aktgjykimin nr.72/2022, andaj dhe në këtë procedurë të konfliktit administrativ ka konstatuar se me procesverbalin e datës 30.08.2013 vetëm pas selektimit për kontrollë të pasagjerit i njëjti ka deklaruar se posedon mjete

monetare, e sipas të cilit procesverbal ky selektim ka ardhur *pas kontrollit të pasaportave dhe kalimit të kontrollës X-ray në ANP*, i cili procesverbal është hartuar nga zyrtari kompetent. Për të mbështetur këtë fazë se kur është bërë deklarimi dhe në cilën fazë është bërë deklarimi i posedimit të mjeteve monetare Gjykata e shkallës së parë mori për bazë edhe pohim e këtu paditësin si në padi i cili thekson se nuk ka kuptuar mbishkrimin dhe se nuk e ka ditur se nëse një udhëtarë ka para më shumë se 10 000 euro ai duhet ti deklaroi, pra këtu paditësi me deklarin e tij nuk mohon fazën në të cilën ka deklaruar se posedon mjete monetare, por se i njëjti ka arsyetuar veprimet e tij me mos njohurin se duhet të deklaroj dhe po ashtu mos njohjen e gjuhës e të cilat pretendim ishin të pabazuara sepse i njëjti nga deklarata e shkruar nga paditësi në gjuhën shqipe, me shkrim dorë dëshmon për gjykatën se është njohës i gjuhës shqipe sepse deklarata në shkresat e lëndës mban emrin dhe mbiemrin si dhe nënshkrimin e paditësit dhe e njëjta është bashkangjitur nga vet paditësi me padi dhe nuk është kontestuar në asnjë fazë të procedurës, kurse mos njohuria për deklarim nuk paraqet bazë për ta liruar nga përgjegjësi paditësin sepse i njëjti ka pasur mjaftueshëm informata brenda hapësirës së ANP për procedurën dhe hapësirën e deklarinimit monetar dhe po ashtu kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Gjykata e shkallës së parë konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se padia e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se nuk ekziston asnjë prove se paditësi ka fshehur mjetet monetare, apo ka tentuar ti shmanget kontrollit doganorë për të deklaruar mjetet monetare. Në momenti e parë në piken doganorë të aeroportit kur paditësi është pyetur nga personi zyrtar se a posedon mjete monetare, paditësi është përgjigjur se ka me vete 20.000 SFR (CH Franga) dhe se këto mjete i ka prezantuar e edhe prejardhjen e tyre. Prandaj duke mos pas parasysh këtë gjendje faktike në rastin konkret nuk mund të ngarkohet me shkelje doganorë në vështrim të nenit 29 par.4 të Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Këto pretendime ankimore gjithashtu janë të pa bazuara, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ngase, aktvendimi i organit administrativ i të paditurës, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse paditësi nuk ka ofruar fakte që të kontestoj provat e të paditurës Dogana e Kosovës. Andaj, nga provat e administruara edhe në procedurën e konfliktit administrativ është vërtetuar se organi i paditur ka

vepruar drejt kur subjektin në procedurë e ka shpallur përgjegjës për veprime të bëra të cilat janë të kundërligjshme.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjen se gjykata e shkallës së parë, nga dëshmitë e nxjerra me të drejtë ka konstatuar se Dogana e Kosovës, ka vepruar drejt kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e subjektit në procedurë. Sepse, paditësi nuk ka arritur që të paraqes prova të mjaftueshme që dëshmojnë të kundërtën e konstatimeve nga vendimi i kontestuar i të paditurës. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate nuk i merr si të bazuara pretendimet se e paditura dhe gjykata e shkallës së parë gabimisht kanë vërtetuar gjendjen faktike, dhe me këtë rast gabimisht kanë aplikuar edhe dispozitat ligjore, si dhe pretendimin se aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-se, se është i paqartë e në kundërshtim me vetveten e me faktet vendimtare e me provat e administruara. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt, kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA dhe Ligjin 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-178.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Andaj pretendimet e të autorizuarit të paditësit, ky kolegji nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pabazuara, dhe nuk mund të qojnë në ndonjë vendim tjetër, se nuk janë të mbështetura në prova për vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur dhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit dhe lënies në fuqi të aktvendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
AA.nr.189/2023, me datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,  
Ramiz Kuqi